



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 24.11.1-2017-08

RAPORTI I AUDITIMIT

**PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KËSHILLIT TË
PAVARUR MBIKQYRËS TË SHËRBIMIT CIVIL PËR VITIN E
PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017**

Prishtinë, qershor 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në konsultim me Ndhimës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Udhëheqësi i ekipit Edona Abazi-Demolli, dhe Anëtares së ekipit Lindita Ajeti, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Faruk Rrahmani.

TABELA E PËRMBAJTJES


Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	10
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	14
5 Qeverisja e mirë.....	15
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	17
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake.....	20
Shtojca III: Letërkonfirmimi	21

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 07/05/2018.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil.

Zyra Kombëtare e Auditimit e vlerëson bashkëpunimin e treguar nga menaxhmenti i lartë dhe stafi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil gjatë procesit të auditimit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm


Opinion i pamodifikuar

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



Përgjigja e Menaxhmentit

Menaxhmenti i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshinë ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil (tash e tutje Këshilli). Ne kemi analizuar veprimtarinë e Këshillit, se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontroleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar

Ne kemi audituar PFV-të e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin, Nr. 03/L-221, Nr. 04/L-116, Nr. 04/L-194 dhe Ligjin, Nr. 05/L-063), dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Drejtori Ekzekutiv i Sekretariatit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është

përgjegjës për kontrolle të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin, Nr. 03/L-221, Nr. 04/L-116, Nr. 04/L-194 dhe Ligjin, Nr. 05/L-063).

Drejtori Ekzekutiv i Sekretariatit është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Këshillit.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbuloj çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Këshilli kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin, Nr. 03/L-221, Nr. 04/L-116, Nr. 04/L-194 dhe Ligjin, Nr. 05/L-063);
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve;
- Planin dhe raportin përfundimtar të Prokurimit; dhe
- Raportet për obligimet e papaguara.

Të gjitha kërkesat për raportim si në kontekst të PVF-ve ashtu edhe të raportimit të jashtëm ishin përmbushur me një cilësi të mirë dhe ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime lidhur me PFV-të.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore, pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi shpenzimet në përgjithësi janë të përshtatshme dhe janë duke u zbatuar në mënyrë efektive.

Megjithatë kontrollet mbi fushën e menaxhimit të pasurive kërkohet të përmirësohen në lidhje me funksionalizimin e sistemit e-pasuria për pasuritë nën 1,000€.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e tyre sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Burimet e Fondeve:	372,734	356,822	338,728	298,213	276,872
Granti i Qeverisë -Buxheti	372,734	356,822	338,728	298,213	276,872

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 15,912€. Me rishikim të buxhetit dhe me vendim të Qeverisë nr.10/19 të datës 15.12.2017, investimet kapitale janë reduktuar 25,000€ (plotësisht), kurse shërbimet komunale në vlerë prej 956€. Përderisa kategoria e mallrave dhe shërbimeve ishte rritur për 9,956€, dhe ajo e pagave dhe mëditjeve për 88€.

Në vitin 2017, Këshilli ka shpenzuar 95% të buxhetit final ose 338,728€, që tregon se realizimi i buxhetit është në nivel të kënaqshëm. Më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

¹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	372,734	356,822	338,728	298,213	276,872
Pagat dhe Mëditjet	236,507	236,595	236,595	231,927	221,602
Mallrat dhe Shërbimet	107,402	117,358	99,416	63,837	52,082
Shërbimet Komunale	3,825	2,869	2,717	2,449	3,187
Investimet Kapitale	25,000	-	-	-	-

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Buxheti final për kategorinë e mallrave dhe shërbimeve ishte rritur për 9,956€ me qëllim të mbulimit të shpenzimeve të planifikuara për marrjen me qira të automjeteve. Pavarësisht rritjes së buxhetit, realizimi për këtë fushë është 85%. Ky nivel i shpenzimeve ka ndodhur për shkak të mos zhvillimit të procedurave të prokurimit nga ana e Agjencia Qendrore e Prokurimit për kontraktim të automjeteve me qira; dhe
- Në kategorinë e investimeve kapitale të gjitha mjetet e planifikuara me buxhetin fillestar ishin reduktuar. Edhe pse Këshilli kishte planifikuar blerjen e automjeteve gjatë vitit 2017, menaxhmenti kishte vlerësuar si më ekonomike kontraktimin e tyre me qira (bazuar në Udhëzimin Administrativ nr.03/2017, si dhe praktikat e disa Institucioneve tjera të Pavarura).

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.2 Pagat dhe shtesat

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga Ministria e Administratës Publike dhe MF. Sipas shënimeve të SIMFK-së, buxheti për kategorinë e pagave dhe shtesave ishte 236,595€, të cilat ishin shpenzuar 100%.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.3 Menaxhimi i personelit

Numri i planifikuar i stafit ishte 26, numër ky i njëjtë me atë aktual deri në dhjetor të vitit 2017, përfshirë 19 punonjës në njësinë operative dhe shtatë anëtarë të Bordit përfshirë kryetarin, të cilët janë emëruar nga Kuvendi i Kosovës.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.4 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime, duke përfshirë shërbimet komunale në vitin 2017 ishte 120,227€. Prej tyre ishin shpenzuar 102,133€. Ne kemi rishikuar proceset e blerjes së mallrave apo shërbimeve të pranuar. Nga këto testime, vlerësojmë se Këshilli kishte arritur të zbatojë kërkesat ligjore, qofshin financiare apo ato të prokurimit.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.5 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Vlera neto e pasurive kapitale e shpalosur në PFV ishte 2,971€. Kurse, pasuri jo kapitale ishin 30,535€, dhe vlera e stoqeve ishte 1,333€.

Ne kemi rishikuar nëse procesi i regjistrimit dhe mënyra e mbajtjes së evidencave është në pajtueshmëri me kërkesat e rregullës së MF-Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore, procesin e inventarizimit, zhvlerësimin dhe ekzistencën fizike të pasurive.

Çështja 1 - Mos funksionalizimi i sistemit e-pasuria

- E gjetura** Rregullorja për menaxhimin e pasurive kërkon që pasuritë jo kapitale dhe stoqet të regjistrohet në sistemin “e-Pasuria”. Këshilli ende nuk e ka në funksion sistemin e-Pasuria, përkundër që kishte bërë kërkesa në MAP për funksionalizimin e këtij sistemi.
- Në mungesë të këtij sistemi, regjistri i pasurisë me vlerë nën 1,000€ është duke u mbajtur në Excel. Zhvlerësimi i këtyre pasurive ishte kryer në mënyrë manuale nga zyrtari i pasurisë.
- Rreziku** Mbajtja e pasurive jo kapitale në Excel ku ekziston mundësia e ndryshimeve në çdo kohë pa lënë ndonjë gjurmë, rritë rrezikun e gabimeve si në evidentim të pasurive ashtu edhe në përlogaritje të zhvlerësimit. Krejt kjo mund të rezultojë në ekspozimin e pasurive pranë rrezikut të keq menaxhimit të tyre, dhe në mos përmbushjen e kërkesave të raportimit financiar të pasurisë.
- Rekomandimi 1** Kryetari i Këshillit duhet të vazhdojë tutje bashkëpunimin dhe përpjekjet me MAP-in për të siguruar funksionalizimin e sistemit e-pasuria, në mënyrë që menaxhimi dhe raportimi i pasurisë të bëhet në përputhje me kërkesat e rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare.

3.6 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2017 ishte 2,975€, prej tyre 2,728€ ishin obligime të papaguara nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, ndërsa 248€ për shërbime komunale. Të gjitha këto janë fatura për shërbimet e pranuar në fund të vitit 2017. Këshilli kishte raportuar në baza të rregullta mujore për obligimet e papaguara.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e Këshillit për vitin 2016, ka rezultuar me pesë rekomandime kryesore. Menaxhmenti kishte ndërmarrë veprime për t'i adresuar çështjet e ngritura, dhe pjesa më e madhe e tyre kishte gjetur zbatim të plotë.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2017, katër rekomandime janë zbatuar dhe një nuk është zbatuar ende. Rekomandimi i pazbatuar lidhet me mos aplikimin e sistemit e-pasuria për pasuritë jokapitale. Në vitin 2015 nuk kishte asnjë rekomandim të dhënë për Këshillin.

Një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato shihni Shtojcën II.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

5 Qeverisja e mirë

Hyrje

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA-së me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i një pjese të madhe të rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmer veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK-së nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i pyetësorëve të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen MF-së.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjerë janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Këshilli në përgjithësi ka kontrolle të mira në raport me obligimet ligjore të saj. Menaxhimi financiar dhe kontrolli ka dëshmuar proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera të kontrollit.

Këshilli ka zbatuar pjesën më të madhe të rekomandimeve si dhe ka përgatitur regjistrin e rreziqeve, duke identifikuar të gjitha rreziqet domethënëse që mund të kenë ndikim tek organizata në lidhje me arritjen e objektivave të saj.

Megjithatë deri në fund të auditimit tonë nuk është vërejtur se është bërë vlerësimi, monitorimi dhe azhurnimi i regjistrit të rreziqeve.

5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Sipas UA Nr. 23/2009 për themelimin dhe funksionimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm (NJAB), Këshilli nuk i plotëson kriteret për themelimin e kësaj njësie. Gjatë vitit 2017, Këshilli kishte paraqitur kërkesë për auditim në Divizionin Qendror për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm pranë MF-së. Gjatë periudhës sonë audituese auditimi i brendshëm nga kjo njësi ishte në proces.

Rekomandime

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalesje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, megjithatë menaxhimi dhe azhurnimi i regjistrit të rreziqeve mbetet çështje e cila duhet përmirësuar tutje.

Çështja 2 - Dobësi në menaxhimin e rreziqeve

- E gjetura** Sipas rregullave të MFK-së, Këshilli ka krijuar procedura formale dhe të dokumentuara të vlerësimit dhe përgatitjes së regjistrit të rreziqeve. Megjithatë edhe pse ky regjistër është hartuar, ai nuk është duke u menaxhuar në mënyrë aktive për sa i përket monitorimit, azhurnimit dhe sigurimit se janë ndërmarrë veprime për të parandaluar dhe zbutur rreziqet.
- Rreziku** Mungesa e menaxhimit të rrezikut mund të pamundësojë reagimin me kohë ndaj rreziqeve me të cilat ballafaqohet organizata, qofshin ato nga mjedisi i brendshëm apo i jashtëm. Kjo për shkak se veprimet pro aktive të nevojshme për të parandaluar ose evituar ndikimin e çështjeve të tilla nuk do të ndërmerren në mënyrë të planifikuar dhe sistematike.
- Rekomandimi 2** Kryetari i Këshillit duhet të siguroj azhurnim efektiv të rreziqeve dhe monitorim të vazhdueshëm të tyre, me qëllim të parandalimit dhe zbutjes së rreziqeve dhe zbatimit të kërkesave në këtë fushë.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:




- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake

Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
1.3 Rekomandimet për pjesën e parë të raportit	Kryetari i Këshillit duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që procesi i hartimit të PFV-ve 2017 i adreson të gjitha çështjet e identifikuara. Në këtë aspekt, të ndërmarrë veprimet e duhura për sigurimin e informatave në kohë lidhur me kursimet buxhetore që ndodhin në fund vit, në mënyrë që të pasqyrohet saktë buxheti final në PFV.	Po		
2.2 Pyetësori i vetëvlerësimit	Kryetari Këshillit duhet të sigurojë se janë marrë masat për hartimin e planit strategjik të KPMSHCK-së, i cili do të shërbente si dokument kornizë (bazë) për përcaktimin e planeve operative, si dhe për realizimin dhe monitorimin e tyre.	Po		
2.3 Sistemi i Auditimit të Brendshëm	Kryetari i Këshillit duhet të siguroj se janë marrë masat e nevojshme që procesi i auditimit të brendshëm kryhet sipas afateve të parapara.	Po		
3.1.2 Mallra dhe Shërbime	Kryetari i Këshillit duhet të sigurojë se, të gjitha mallrat dhe shërbimet pranohen nga komisionet përkatëse në mënyrë që mallrat dhe shërbimet e pranuar të jenë sipas kërkesave të kontraktuara.	Po		
3.2.1 Pasuritë	Kryetari i Këshillit duhet të sigurojë se janë ndërmarr të gjitha masat e nevojshme që pasurit jo kapitale nën 1,000€ dhe stoqet regjistrohen dhe menaxhohen përmes sistemit e-pasuria. Po ashtu duhet të sigurojë se rishikohen vlerat e zhvlerësuara të këtyre pasurive ekzistuese.			Nuk janë marrë masa.

Shtojca III: Letërkonfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
 KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
 NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
 INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranimi / Dorëzuar / Prilaz / Delivered / Rücksend / Delivery	18 - 06 - 2018	8	viti / god / year
Organizata / Organizacija / Organi / Organization / Organi / Organisation	SKPMSHCK	3365/2018	111
Adresa / Adresa / Adresa / Address / Adresa / Address			
Shifra / Shifra / Shifra / Code / Shifra / Code			
Shifra / Shifra / Shifra / Code / Shifra / Code			
Shifra / Shifra / Shifra / Code / Shifra / Code			
Shifra / Shifra / Shifra / Code / Shifra / Code			
Shifra / Shifra / Shifra / Code / Shifra / Code			

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2017 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- Pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit, përjashtimisht lidhur me rekomandimin nr.1.ku obligohet Kryetari i Këshillit që të ndërmerr të gjitha veprimet në kuptim të funksionalizimit të sistemit të e-pasurisë. Lidhur me këtë ne ju sigurojmë se sa i përket anës tone ne do të angazhohemi ashtu si ne të kaluarën që ky sistem të funksionalizimet sa më shpejtë që është e mundur.
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Data: 18.06.2018, Prishtinë,

Drejtori Ekzekutiv i S/KPMSHCK
(Miran Zeneli)

